



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Ministri Ahmetaj në Kukës, Përpyekja për politizimin e protestës dështoi. Nuk ka taksë të re për biznesin, nuk ka ngarkesë fiskale të shtuar, nuk ka gjoba për gabimet në deklarim”.

2018-04-11 08:20:00



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ishte sot në Kukës, ku u takua me përfaqësues të bizneseve të vegjël për të diskutuar mbi uljen e pragut të TVSH. Ky është takimi i parë që qeveria organizon në Kukës, pas protestës për tarifën e Rrugës së Kombit.

Në fjalën e tij, Ahmetaj tha se Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Administrata tatimore është duke ndërmarrë një fushatë të gjerë informimi, komunikimi, trajnimit dhe asistimi për bizneset e vegjël në të gjithë vendin, që afektohen nga ulja e pragut të TVSH, tur i cili fillon pikërisht nga qyteti i Kukësit.

“Dua t’i falenderoj të gjithë bizneset e vegjël të Kukësit që dje nuk i ulën qepenat. U gëzova pa masë kur që këtu nga Kukësi, më thanë që qyteti ka refuzuar të mbyllë qepenat, më thanë që qyteti ka refuzuar ta kthejë një çështje normale ekonomike dhe fiskale në çështje politike.

Pikë së pari dhe mbi të gjitha dje, nëse e patë, të vetmet grupe të biznesit të vogël që kanë mbyllur qepenat kanë qenë tregjet.

Tregjet e bashkive, tregjet e fruta-perimeve, fermerët dhe të gjithë ata që janë me xhiro në 2 milionë, janë të përjashtuar nga detyrimi.

Pra imagjinoni se çfarë ndodhi dje, kur politika tentoi të politizonte, pa informacion apo me qëllimshmëri, një aktivitet normal ekonomik dhe fiskal dhe kjo është dhe arsyeja pse një protestë me tendencë politike dështoi” – tha Ahmetaj.

Ministri theksoi sërish se TVSH është një taksë indirekt për TVSH, e cila paguhet nga konsumatori dhe detyrimi për deklarim, nuk parashikon asnjë ngarkesë të shtuar fiskale për biznesin, as rritje cmimesh për konsumatorin.

“E dyta, që është shumë e rëndësishme, miq të dashur, ky nuk është një tatim apo një taksë e re.

Viti i parë kur ka nisur të aplikohet TVSH-ja ka qenë mesi i ‘96 dhe fillimi i ‘97. Pra, është një taksë e vjetër, nuk është një taksë e re dhe nuk ka rëndësi nëse je biznesi i vogël apo je biznesi i madh, kostoja e TVSH, është në cmimin që paguan konsumatori, nuk ka rëndësi nëse është e deklaruar drejtpërsëdrejti apo e fshehur në çmim, konsumatori e paguan në çdo rast.

Bizneseve nuk do t’u rriten kostot. Pse? Sepse kush është biznesi i vogël e di që sot deklaroi një herë në tre muaj kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe prapë një herë në tre muaj do të deklarohet në një deklaratë të thjeshtësuar.

Dhe këtu, duke filluar që nga unë i pari dhe deri te punonjësi më i thjeshtë i Tatimeve do të vijë derë më derë tek ju për t’ju sqaruar.

Derë më derë tek çdo biznesi i vogël në Republikën e Shqipërisë, për t’i sqaruar me qetësi dhe me përlulësi këdo që është i paqartë.

Pra, nuk ka rritje takse. Nuk është taksë e re. Nuk rriten çmimet dhe mbi të gjitha nuk do të ketë asnjë gjobë për deklarim të gabuar” – tha Ministri.

kontributi I të cilëve në të ardhurat e përgjithshme nga TVSH, është vetëm 0.08% e totalit. Fokusi mbetet biznesi I madh dhe formalizimi i ekonomisë.

“Biznesi i vogël të vazhdojë me qetësi punën e vet. Jemi në një normalitet ekonomik, përtej asaj që bën opozita për ta trazuar këtë procedurë ekonomike fiskale financiare me emocione politike.

Madje, në 2011-ën, miq të dashur, qeveria e Sali Berishës ka vendim me protokoll, të pa kaluar, për ta ulur nga 5 në 2. Qëllimi është i njëjtë, formalizimi. Nuk është fokusi te biznesi i vogël, 0.08 % nga gjithë shuma që mbledh buxheti i shtetit nga TVSH-ja dhe kjo tregon shumë qartësisht që nuk është fokusi te biznesi i vogël. Biznesi i vogël mbështetet për të promovuar punësimin dhe vetëpunësimin sidomos në zona që kanë nevojë për mbështetje nga qeveria siç është qarku i Kukësit me Kukës, Has, Tropojë” – përfundoi Ahmetaj.

Pjesë e diskutimit me bizneset ishin edhe tarifa e rrugës së Kombit, për të cilën Ministri tha se qeveria është në negociatë të përsheptuar me koncesionarin për të arritur në një paketë shumë të lehtësuar në favor të banorëve të Kukësit.

Duke folur për investimet në zonë, Ministri përmendi dy projekte të mëdha, që do të reflektohen në ekonominë e rajonit dhe punësim, hapja së shpejti e një kompanie të madhe në sektorin fason e cila do të krijojë rreth 500 vende të reja pune dhe avancimi i negociatave për aeroportin e Kukësit.